



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË SHORTIT PËR NDARJEN E BANESAVE/
APARTAMENTEVE NË OBJEKTET E REJA TË BANIMIT, TË NDËRTUARA NË KUADËR TË
PROCESIT TË RINDËRTIMITNr. 8404 prot.Tiranë, më 1, 2, 2024

Lënda: Për njoftimin e zhvillimit të shortit publik, për shpërndarjen e njësive të banimit dhe sistemimin e subjekteve përfituese të programit të zhvillimit të objekteve të reja.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE
INOVACIONIT

NJËSISË ADMINISTRATIVE PEZË

Referuar parashikimeve të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, parashikohet zhvillimi i një shorti, për shpërndarjen e njësive të banimit për sistemimin e subjekteve përfituese të programeve të rindërtimit. Gjithashtu në këtë vendim, parashikohet se rregulla të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të procesit të shorteut publik dhe të hapur miratohen me vendim të këshillave bashkiakë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Me anë të vendimit nr. 142, datë 19.11.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shorteut publik dhe të hapur, në kuadër të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, është miratuar rregullorja për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shorteut, e cila përcakton funksionimin e procesit të hedhjes së shortit dhe strukturave përgjegjëse për organizimin e tij, me qëllim caktimin e njësive përkatëse të banimit në objektet e reja për sistemimin e subjekteve përfituese të programeve të rindërtimit.

Në nenin 9, të kësaj rregulloreje, parashikohet krijimi i një komisioni për organizimin e shortit, i cili është ngritur me urdhrin nr. 48208/6, datë 07.12.2021, të kryetarit të Bashkisë, të ndryshuar. Komisioni në zbatim të rregullores në fjalë, pasi ka hartuar një listë përfundimtare të përfituesve, duhet të vijojë me caktimin e datës, orës dhe vendin e hedhjes së shortit dhe të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë Tiranë, për kryerjen e njoftimit të përgjithshëm dhe individual, për zhvillimin e shortit.

Procedura e detajuar për njoftimin e zhvillimit të shortit, rregullohet në pikat 20.11, 20.12 dhe 20.13, të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programetë procesit të rindërtimit”, në të cilat parashikohet për sa më poshtë vijon:

20.11 “Njoftimi i përgjithshëm për shorteun publik duhet të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga të gjithë dhe bëhet 15 (pesëmbëdhjetë ditë) përpara datës së hedhjes së shorteut nëpërmjet lajmërimeve publike, të cilat afishohen në ambientet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale, si dhe me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Njoftimi duhet të përmbajë listën e përfituesve dhe vendndodhjen/zonën e objektit”.

20.12 “Krahas njoftimit të përgjithshëm për hedhjen e shortit, bëhet edhe thirrja, nëpërmjet njoftimit të çdo përfituesi, pjesë e shortit publik për pjesëmarrje në këtë shorte, e cila duhet të përmbajë:

- a) njësinë e vetëqeverisjes vendore që e ka nxjerrë;
- b) emrin, mbiemrin e personit të thirrur, përfitues nga programi i rindërtimit;
- c) përbërjen familjare dhe strukturën e banesës takuese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
- ç) vendndodhjen/zonën ku është/janë ndërtuar objekti/objektet ose zona sipas marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë;
- d) vendin dhe datën e organizimit të shorteut publik;
- dh) si dhe pasojat në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në shorte.

20.13 “Njoftimi shkresor nëpërmjet letërthirrjes bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi i njësisë vendore ose shërbimi postar. Në çdo rast në lidhje me njoftimin e përfituesit mbahen në konsideratë, për aq sa është e mundur, dispozitat e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër, po ju përcjellim dy listat e subjekteve përfituese, njëra prej të cilave përmban kriteret e përparësisë, dhe formatin e njoftimit individual dhe të përgjithshëm, për të vijuar sipas fushës suaj të përgjegjësisë, me procedurat për njoftimin e individëve, pjesë të shortit publik i cili do të mbahet më datë 16.02.2024, ora 11:00, brenda ambienteve të lagjes së re “Pezë.

KRYETARI I KOMISIONIT


Arjola Elezi

LISTA NR.1 ME KRITERE PERPARESIE

Emër	Atësi	Mbiemër	Perberja Familjare	Struktura Familjare	NR.ID	Nr. Aplikimi	Kriteret e perparësise	VKB
Gani	Beqir	Karaj	2	1+1	E11215065J	25412	Pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Hide	Muharrem	Karaj	1	1+1	E75402093P	36697	Pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021

Emër	Atësi	Mbiemër	Perberja Familjare	Struktura Familjare	NR.ID	Nr. Aplikimi	Kriteret e perparësise	VKB
Zyhdi	Caush	Gjumsi	3	2+1	G20329028K	5982	Ndihme ekonomike	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Artur	Petrit	Karaj	4	2+1	H71220054F	12958	Ndihme ekonomike	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Hamdi	Hasan	Tresa	3	2+1	F60506075H	26218	Ndihme ekonomike	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Eles	Hasan	Tresa	3	2+1	F30514054W	33256	Invalid pune, pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021

Emër	Atësi	Mbiemër	Perberja Familjare	Struktura Familjare	NR.ID	Nr. Aplikimi	Kriteret e perparësise	VKB
Nazmi	Skender	Hasa	5	3+1	I20712043F	5420	Ndihme ekonomike	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Skender	Hajdar	Hasa	5	3+1	F70402149C	5486	PAK	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Abdulla	Zenel	Tresa	6	3+1	F30406093W	13240	Pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Bedri	Daut	Karaj	8	3+1	F00603067V	26796	Verberi , pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
Hamdi	Allaman	Uku	5	3+1	F80511158E	37811	Pensionist	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021

LISTA NR. 2 PA KRITERE PERPARESIE

Nr.	Njësia Administrative	Emër	Atësi	Mbiemër	Perberja Familjare	Struktura Familjare	NR.ID	Nr. aplikimi	VKB
1	Peze	Ali	Beqir	Cerka	2	1+1	D70323040B	27066	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
2	Peze	Daut	Telha	Shima	2	1+1	E01111035K	28539	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
3	Peze	Asllan	Selman	Shima	2	1+1	F70801043B	29977	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021

Nr.	Njësia Administrative	Emër	Atësi	Mbiemër	Perberja Familjare	Struktura Familjare	NR.ID	Nr. aplikimi	VKB
4	Peze	Qemal	Hajdar	Hasa	4	2+1	H50301056R	5317	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
5	Peze	Alfred	Zyhdi	Gjumsi	3	2+1	I80619131D	6595	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
6	Peze	Zenel	Hamdi	Tresa	4	2+1	I20417066N	26377	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
7	Peze	Durim	Mahmud	Hasa	4	2+1	H30423043F	27636	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
8	Peze	Petrit	Selman	Shima	3	2+1	G21215032N	28326	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
9	Peze	Sinan	Rexhep	Shima	3	2+1	I00115033Q	28490	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
10	Peze	Rexhep	Telha	Shima	3	2+1	D80210133D	31670	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021
11	Peze	Flamur	Ali	Cerka	4	2+1	I00115032I	58076	Vkb Nr.63 Dt.19.04.2021

BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më __, __, 2024

Lënda: Njoftim për pjesëmarrje në shortin publik.

ZOTIT _____
Adresa: _____

Në mbështetje të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 19.11.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shorteut publik dhe të hapur, në kuadër të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, ju njoftojmë se:

Bashkia Tiranë, më datë 16.02.2024, ora 11:00, brenda ambienteve të lagjes së re “Pezë”, organizon shortin publik për përzgjedhjen e njësive të reja të banimit, në objektet e ndërtuara në lagjen e re “Pezë”, për sistemimin e subjekteve përfituese të programeve të rindërtimit. Shorti publik do të hidhet për strukturën e banesës takuese sipas përcaktimeve të vendimit të këshillit bashkiak Tiranë për të cilën ju jeni shpallur përfitues. Konkretisht sipas përbërjes tuaj familjare prej ___ anëtarësh, jeni shpallur fitues për strukturën e banimit ___+___.

Procedura e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së njësisë së banimit në objektet e reja, do të bëhet sipas parashikimeve të rregullores së miratuar për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shorteut publik dhe të hapur, në kuadër të procesit të rindërtimit, të cilën e gjeni të afishuar pranë njësisë administrative dhe faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Tiranë.

Lutemi të merrni masa që ju apo përfaqësuesi juaj me prokurorë të jeni të pranishëm në shortin publik, ku nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nga ana juaj do të bëhet përzgjedhja e njësisë së re të banimit.

Në rast se ju apo përfaqësuesi juaj, nuk paraqiteni edhe pse keni marrë rregullisht njoftimin, atëherë të drejtën e përzgjedhjes e ushtron Kryetari i Komisionit, në prani edhe të subjekteve të tjera përfituese dhe rezultati i përzgjedhjes pasqyrohet në procesverbal në të cilin evidentohet e gjithë kjo procedurë.

ADMINISTRATOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË SHORT PUBLIK

Bashkia Tiranë, më datë 16.02.2024, ora 11:00, brenda ambienteve të lagjes së re “Pezë”, organizon shortin publik për përzgjedhjen e njësive të reja të banimit, në objektet e ndërtuara në lagjen e re “Pezë” për sistemimin e subjekteve përfituese të programeve të rindërtimit me strukturën e banesës sipas listave bashkëlidhur.

Procedura e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së njësisë së banimit në objektet e reja, do të bëhet sipas parashikimeve të rregullores së miratuar për mënyrën e zhvillimit të procedurës së shorteut publik dhe të hapur, në kuadër të procesit të rindërtimit, të cilën e gjeni të afishuar pranë njësisë administrative dhe faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Tiranë.

Lutemi të merrni masa që ju apo përfaqësuesi juaj me prokurorë të jeni të pranishëm në shortin publik, ku nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nga ana juaj do të bëhet përzgjedhja e njësisë së re të banimit.

Në rast se ju apo përfaqësuesi juaj, nuk paraqiteni edhe pse keni marrë rregullisht njoftimin, atëherë të drejtën e përzgjedhjes e ushtron Kryetari i Komisionit, në prani edhe të subjekteve të tjera përfituese dhe rezultati i përzgjedhjes pasqyrohet në procesverbal në të cilin evidentohet e gjithë kjo procedurë.